

Program trajnimi dhe manual për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian



Kingdom of the Netherlands



ЦЕНТАР ЗА ПРАВНИ
ИСТРАЖУВАЊА И АНАЛИЗИ
CENTER FOR LEGAL RESEARCH AND ANALYSIS



Titulli:

Program trajnimi dhe manual për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian

Botuesi:

Center for Legal Research and Analysis (CLRA), North Macedonia
Civil Rights Defenders, Serbia
Civil Rights Defenders, Albania
Civic Alliance, Montenegro

Autor:

dr Šejla Imamović,
Asistente Profesore e së Drejtës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Maastricht-it

Redaktimi dhe kontributi profesional:

Milena Josifovska, CLRA
Martina Zafirovska, CLRA
Klejda Ngjela, Civil Rights Defenders Albania

Dizajni grafik:

Relativ

Vendi dhe viti i botimit:

Shkup, 2026

Ky publikim është hartuar në kuadër të projektit “Forcimi i Bashkëpunimit Gjyqësor Rajonal në Ballkanin Perëndimor për Ndjekjen Efektive të Çështjeve para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian”, i mbështetur nga Mbretëria e Holandës. Autorët mbajnë përgjegjësi të plotë dhe ekskluzive për përmbajtjen e këtij publikimi. Përmbajtja e tij nuk duhet të interpretohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve apo pikëpamjeve zyrtare të Mbretërisë së Holandës.

Tabela e Lëndës

LISTA E SHKURTESAVE	4
I. HYRJE DHE KUADRI I TRAJNIMIT	5
1. Hyrje	5
1.1 Qëllimi dhe Fusha e Zbatimit të Kurrikulës	5
1.2 Sfondi i Projektit dhe Konteksti Rajonal	5
1.3 Grupi i synuar, njohuritë dhe aftësitë praktike që synohet të zhvillohen	6
1.4 Përputhshmëria me Standardet e Bashkimit Evropian dhe Parimet e Trajnimit Gjyqësor	6
II. ZBATIMI I KARTËS SË TË DREJTAVE THEMELORE	7
2.1 Moduli 1: Të kuptuarit e Kartës	7
2.2 Moduli 2: Praktika gjyqësore në lidhje me Kartën	11
2.3 Moduli 3: Analiza praktike e rastit	13
2.4 Moduli 4: Diskutim	14
III. METODOLOGJIA E TRAJNIMIT	16
3. Metodologjia e Trajnimit	16
3.1 Roli dhe Përgjegjësitë e Trajnerëve Kombëtarë	16
3.2 Strukturimi dhe Zhvillimi i një Sesioni Kombëtar Trajnimi	16
3.3 Teknikat e Facilitimit për Profesionistët e së Drejtës	17
3.4 Axhenda për Sesionet Kombëtare Pasuese të Trajnimit	18
IV. MATERIALET E TRAJNIMIT DHE ANEKSET	19
4.1 Tabelë: Klasifikimi i Dispozitave të Përzgjedhura të Kartës (Moduli 1)	19
4.2 Pasqyrë e Jurisprudencës (Moduli 2)	20
4.3 Përmbledhje e Studimeve të Rasteve (Moduli 3)	28
4.4 Udhëzues i Shkurtër Hap pas Hapi për Trajnerët (për të gjitha modulet)	31
4.5 Lidhje me Burimet Kryesore dhe Udhëzime Shoqëruese	32

Lista e shkurtesave

AKT	Auto-ja Kuljetusalan Työntekijäliitto
AMS	Association de médiation sociale
BE	Bashkimi Evropian
CCCS	Të nxënit konstruktiv, kontekstual, bashkëpunues dhe i vetëdrejtuar
DEB	DEB Deutsche Energieberatung GmbH
EJTN	Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor
GJDBE	Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KDFBE	Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian
KE	Komuniteti Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
PBL	Të nxënit e bazuar në probleme
PPU	Procedura Paraprake Urgjente
TBE	Traktati për Bashkimin Evropian
TSN	Työtehoseura ry
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

I. HYRJE DHE KUADRI I TRAJNIMIT

1. Hyrje

1.1 Qëllimi dhe Fusha e Zbatimit të Kurrikulës

Kjo kurrikulë trajnimi është zhvilluar në kuadër të projektit “Forcimi i bashkëpunimit gjyqësor rajonal në Ballkanin Perëndimor për ndjekjen efektive të çështjeve para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.” Ajo synon të ofrojë një kuadër të strukturuar dhe praktik për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë mbi zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta ose KDFBE).

Kurrikula fokusohet në aspektet kryesore të Kartës që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për autoritetet kombëtare. Në veçanti, ajo trajton: fushën e zbatimit të Kartës; dallimin ndërmjet të drejtave dhe parimeve; nivelin e kërkuar të mbrojtjes gjatë zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian; zbatimin horizontal të dispozitave të Kartës. Këta elementë janë thelbësorë për të përcaktuar nëse dhe në çfarë mënyre Karta është e zbatueshme në raste konkrete.

Kurrikula ka një objektiv të dyfishtë. Së pari, ajo synon t’u ofrojë pjesëmarrësve një kuptim të qartë dhe të strukturuar të kuadrit juridik që rregullon Kartën, duke përfshirë dispozitat përkatëse dhe jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE). Së dyti, ajo synon të zhvillojë aftësinë praktike për ta zbatuar këtë kuadër juridik në situata konkrete. Për këtë arsye, kurrikula kombinon qasjen doktrinare me analizën e rasteve praktike dhe me diskutime të orientuara.

1.2 Sfondi i Projektit dhe Konteksti Rajonal

Edukimi i vazhdueshëm ligjor i profesionistëve të sistemit të drejtësisë luan një rol kyç në forcimin e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe praktikuesve të tjerë të së drejtës. Ai kontribuon jo vetëm në zhvillimin e aftësive profesionale dhe nxitjen e një ndryshimi në mënyrën e të menduarit, por edhe në pajisjen e tyre me njohuritë e nevojshme mbi jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) dhe zbatimin praktik të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian në kuadër të sistemeve juridike kombëtare.

I mbështetur nga Mbretëria e Holandës, projekti rajonal “Forcimi i bashkëpunimit gjyqësor rajonal në Ballkanin Perëndimor për ndjekjen efektive të çështjeve para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian” synon të forcojë kapacitetet e aktorëve të sistemit gjyqësor në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbi dhe Shqipëri për zbatimin efektiv të së drejtës së

Bashkimit Evropian dhe të Kartës së të Drejtave Themelore, në funksion të përgatitjes së tyre për procesin e ardhshëm të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Objektivat specifikë të këtij projekti janë: (i) forcimi i bashkëpunimit rajonal; (ii) shkëmbimi i njohurive mbi sfidat e përbashkëta dhe zgjidhjet që lidhen me Kartën e BE-së dhe procedurat para GjDBE-së; dhe (iii) rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për procedurat para GjDBE-së dhe zbatimin e Kartës së BE-së.

1.3 Grupi i synuar, njohuritë dhe aftësitë praktike që synohet të zhvillohen

Trajnimi është hartuar për gjyqtarët dhe prokurorët publikë në vendet candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ai synon të mbështesë përgatitjen e tyre për anëtarësimin në BE, ku zbatimi i së drejtës së Bashkimit Evropian, përfshirë Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, do të përbëjë një pjesë integrale të praktikës gjyqësore dhe prokuroriale.

Kurrikula synon të zhvillojë si njohuritë teorike, ashtu edhe aftësitë praktike. Për sa i përket njohurive, pjesëmarrësit pritët të fitojnë një kuptim të qartë të fushës së zbatimit të Kartës, të dallimit ndërmjet të drejtave dhe parimeve, si dhe të interpretimit të dispozitave kryesore të Kartës në dritën e jurisprudencës së GjDBE-së. Ata gjithashtu duhet të familjarizohen me marrëdhënien ndërmjet Kartës, së drejtës kombëtare dhe burimeve të tjera të mbrojtjes së të drejtave themelore, siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Për sa i përket aftësive praktike, fokusi është në përgatitjen e pjesëmarrësve për ta zbatuar këtë njohuri në praktikën e ardhshme brenda kuadrit juridik të Bashkimit Evropian. Pjesëmarrësit pritët të zhvillojnë aftësinë për të përcaktuar nëse Karta zbatohet në një situatë të caktuar, për të identifikuar dispozitat përkatëse, për të vlerësuar natyrën e tyre juridike dhe për të zbatuar jurisprudencën relevante në mënyrë të strukturuar dhe të argumentuar.

1.4 Përputhshmëria me Standardet e Bashkimit Evropian dhe Parimet e Trajnimit Gjyqësor

Kjo kurrikulë është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian për trajnimin gjyqësor dhe pasqyron parimet themelore të zhvilluara nga Rrjeti Evropian për Trajnimin Gjyqësor (EJTN). Ajo është hartuar për të siguruar një qasje të qëndrueshme dhe të strukturuar ndaj trajnimit mbi Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, në përputhje me kërkesat e së drejtës së BE-së dhe praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjDBE). Në veçanti, ajo ndjek kuadrin interpretues të Kartës, përfshirë nenet 51 deri në 53 të Kartës, siç janë zhvilluar në jurisprudencën e GjDBE-së.

Njëkohësisht, kurrikula ndjek parimet e përgjithshme të trajnimit gjyqësor, siç janë struktura progresive e të nxënit, qasja e orientuar drejt praktikës, si dhe qëndrueshmëria dhe riprodhueshmëria e metodologjisë (lidhja me dokumentin që shpjegon këto parime gjendet në Aneks). Ajo kombinon një komponent të përmblodhur doktrinar me zbatimin praktik përmes metodës së të nxënit të bazuar në zgjidhjen e problemeve (problem-based learning). Kjo qasje u mundëson pjesëmarrësve të angazhohen në mënyrë aktive me materialin dhe të zhvillojnë aftësi praktike në mënyrë të strukturuar.

II. ZBATIMI I KARTËS SË TË DREJTAVE THEMELORE

2.1 Moduli 1: Të kuptuarit e Kartës

Objektivat e të nxënës

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë natyrën juridike dhe strukturën e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian;
- të identifikojnë rastet kur Karta është e zbatueshme sipas nenit 51 të Kartës;
- të dallojnë ndërmjet të drejtave, parimeve dhe deklarimeve të përfshira në Kartë;
- të kuptojnë marrëdhënien ndërmjet Kartës, së drejtës së Bashkimit Evropian dhe standardeve kombëtare të mbrojtjes së të drejtave themelore.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian fitoi fuqi juridikisht detyruese me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor 2009 dhe sot ka të njëjtën vlerë juridike si traktatet themeluese të Bashkimit Evropian. Përpara hyrjes në fuqi të Kartës, të drejtat themelore mbroheshin në kuadër të së drejtës së Bashkimit Evropian si parime të përgjithshme të pashkruara të së drejtës së BE-së, të frymëzuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare. Këto burime të mbrojtjes së të drejtave themelore pasqyrohen tashmë në nenin 6 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TBE), i cili parashikon:

1. Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e përcaktuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian të datës 7 dhjetor 2000, të përshtatur në Strasburg më 12 dhjetor 2007, e cila ka të njëjtën vlerë juridike si Traktatet. Dispozitat e Kartës nuk zgjerojnë në asnjë mënyrë kompetencat e Bashkimit, siç përcaktohen në Traktate. Të drejtat, liritë dhe parimet e përfshira në Kartë interpretohen në përputhje me dispozitat e përgjithshme të Titullit VII të Kartës, të cilat rregullojnë interpretimin dhe zbatimin e saj, si dhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e referuara në Kartë që përcaktojnë burimet e këtyre dispozitave.
2. Bashkimi do t'i bashkohet Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Një anëtarësim i tillë nuk do të ndikojë në kompetencat e Bashkimit, siç përcaktohen në Traktate.
3. Të drejtat themelore, të garantuara nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe ato që burojnë nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, përbëjnë parime të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Megjithatë, fokusi kryesor i këtij trajnimi mbetet Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, pasi ajo është burimi që përdoret pothuajse ekskluzivisht në jurisprudencën dhe praktikën e Bashkimit Evropian që nga hyrja e saj në fuqi.

Karta përmbledh në një dokument të vetëm një gamë të gjerë të drejtash themelore, duke përfshirë: të drejtat civile; të drejtat politike; të drejtat sociale; të drejtat ekonomike. Gjithashtu, ajo përmban të drejta që kanë rëndësi të veçantë në kontekstin e Bashkimit Evropian, si: liria e lëvizjes; mbrojtja e të dhënave personale; të drejtat që lidhen me shtetësinë e Bashkimit Evropian.


Moduli i parë fillon me njohuritë bazë mbi Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Pjesëmarrësit ftohen të ndjekin lidhjen e përfshirë në Aneksin e këtij materiali për të hapur dokumentin dhe për t'u njohur me përmbajtjen e tij. Fokusi i këtij moduli përqendrohet në karakteristikat kryesore të Kartës së Bashkimit Evropian, me theks të veçantë tek: fusha e zbatimit të saj; dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve; niveli i kërkuar i mbrojtjes në rastet që bien brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Fusha e zbatimit

Pika e nisjes është neni 51(1) i Kartës, i cili parashikon se Karta u drejtohet institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të BE-së, si dhe Shteteve Anëtare “vetëm kur ato zbatojnë të drejtën e Bashkimit”. Kjo dispozitë tregon kufijtë e zbatueshmërisë së Kartës dhe është thelbësore për të përcaktuar nëse aktivizohet kontrolli i të drejtave themelore sipas Kartës.

Në praktikë, kjo do të thotë se autoritetet kombëtare janë të detyruara nga Karta kur veprojnë brenda fushës së zbatimit të së drejtës së BE-së. Kjo përfshin situatat kur masat kombëtare zbatojnë legjislacionin e BE-së, derogojnë nga e drejta e BE-së, ose përndryshe bien brenda fushës së rregulluar nga e drejta e BE-së. Në të kundërt, situatat thjesht të brendshme mbeten jashtë fushës së zbatimit të Kartës. Kjo ndryshon nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e cila ka zbatueshmëri të përgjithshme.

A zbatohet Karta?



Interpretimi dhe efekti juridik

Neni 52 i Kartës ofron udhëzime interpretuese. Neni 52(1) përcakton kushtet në të cilat lejohen kufizimet e të drejtave të Kartës, duke kërkuar që çdo kufizim të parashikohet me ligj, të respektojë thelbin e së drejtës dhe të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Këto korrespondojnë me kërkesat e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, krahas kërkesës që ndërhyrja të respektojë thelbin e së drejtës. Kur preket thelbi i së drejtës, GJDBE-ja përgjithësisht do të konstatojë shkelje.

Për më tepër, neni 52(5) prezanton një dallim thelbësor ndërmjet të drejtave dhe parimeve. Sipas kësaj dispozite, të drejtat duhet të respektohen dhe mund të invokohen drejtpërdrejt përpara gjykatës, ndërsa parimet mund të zbatohen përmes akteve legjislative dhe ekzekutive të miratuara nga institucionet, organet,

zyrat dhe agjencitë e Bashkimit, si dhe përmes akteve të Shteteve Anëtare kur ato zbatojnë të drejtën e Bashkimit, në ushtrimin e kompetencave të tyre përkatëse. Prandaj, parimet nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të njëjtën mënyrë si të drejtat, por ato mund të udhëheqin interpretimin dhe kontrollin e këtyre akteve.

Dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve

Dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve nuk është gjithmonë i shprehur qartë në Kartë dhe shpesh duhet të nxirret nga formulimi, qëllimi dhe struktura e dispozitës përkatëse.

Dispozitat e Kartës që u njohin individëve të drejta duhet të jenë mjaftueshëm të sakta dhe të pakushtëzuara për t'u invokuar përpara një gjykate. Shembuj të tillë janë:

- Neni 4 i Kartës (ndalimi i torturës dhe i trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo poshtërues);
- Neni 21 i Kartës (ndalimi i diskriminimit);
- Neni 47 i Kartës (e drejta për një mjet juridik efektiv dhe për një gjykim të drejtë);
- Neni 31(2) i Kartës (e drejta për pushim vjetor të paguar).

Parimet, në të kundërt, shprehin objektiva më të gjera dhe kërkojnë zbatim të mëtijshëm përmes legjislacionit dytësor (direktivave dhe rregulloreve) përpara se të mund të prodhojnë efekte juridike konkrete. Shembuj përfshijnë:

- Neni 27 i Kartës (e drejta e punëmarrësve për informim dhe konsultim);
- Neni 34 i Kartës (siguria shoqërore dhe ndihma sociale);
- Neni 35 i Kartës (kujdesi shëndetësor).

Ky dallim ka pasoja të rëndësishme për mundësinë e mbrojtjes gjyqësore të dispozitave të Kartës dhe për mënyrën se si gjykatat kombëtare duhet t'i zbatojnë ato.

Përveç kësaj, disa dispozita konsiderohen thjesht deklarata, të cilat përmbajnë gjuhë deklarative ose aspiruese dhe, në përgjithësi, nuk krijojnë të drejta individuale të zbatueshme drejtpërdrejt. Një shembull është neni 22 i Kartës, i cili parashikon se "Bashkimi respekton diversitetin kulturor, fetar dhe gjuhësor."

Nuk ekziston ende qartësi e plotë për natyrën juridike të të gjitha dispozitave të Kartës. Megjithatë, një tabelë që përmban të drejtat, parimet dhe deklaratat, sipas klasifikimit të zhvilluar në jurisprudencën e GJDBE-së, është paraqitur në PJESËN IV.


Përmbledhje e pikave kryesore

Dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve ka rëndësi thelbësore, pasi vetëm ato të drejta që janë mjaftueshëm të sakta dhe të pakushtëzuara mund, në përgjithësi, të invokohen drejtpërdrejt përpara gjykatave kombëtare.

Niveli i mbrojtjes dhe marrëdhënia me standardet kombëtare

Neni 53 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian trajton nivelin e mbrojtjes së të drejtave duke parashikuar se asgjë në Kartë nuk duhet të interpretohet si kufizim apo cenim i të drejtave të njëriut të njohura, ndër të tjera, nga e drejta e Bashkimit Evropian, e drejta ndërkombëtare dhe kushtetutat e shteteve anëtare. Në shikim të parë, kjo dispozitë duket se u lejon shteteve anëtare të ruajnë ose të zbatojnë standarde më të larta të mbrojtjes së të drejtave themelore. Megjithatë, kjo dispozitë duhet të lexohet në

lidhje me strukturën e së drejtës së Bashkimit Evropian, veçanërisht me parimet e epërsisë, unitetit dhe efektivitetit të së drejtës së BE-së. Për rrjedhojë, Karta nuk funksionon si një klauzolë e thjeshtë e “mbrojtjes maksimale”, por më tepër si një dispozitë që ruan burimet ekzistuese të mbrojtjes së të drejtave, pa cenuar funksionimin e rendit juridik të Bashkimit Evropian.



Niveli i mbrojtjes dhe marrëdhënia me KEDNJ-në

Marrëdhënia ndërmjet Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) funksionon në mënyrë të ngjashme me marrëdhënien ndërmjet KEDNJ-së dhe sistemeve kombëtare të mbrojtjes së të drejtave themelore. Në këtë kuadër, Konventa përcakton një nivel minimal mbrojtjeje që shtetet janë të detyruara të garantojnë (në përputhje me nenin 53 të KEDNJ-së), duke u lënë njëkohësisht atyre mundësinë të sigurojnë nivele më të larta mbrojtjeje në rendet e tyre juridike kombëtare. Një qasje e ngjashme është pasqyruar në nenin 52(3) të Kartës, i cili parashikon se, për aq sa të drejtat e garantuara nga Karta korrespondojnë me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja, ato duhet të kenë të njëjtin kuptim dhe të njëjtën fushë veprimi si të drejtat e parashikuara në Konventë. Kjo dispozitë synon të sigurojë koherencë ndërmjet dy sistemeve të mbrojtjes së të drejtave themelore dhe të garantojë që niveli i mbrojtjes i ofruar nga e drejta e Bashkimit Evropian të mos jetë më i ulët se ai i garantuar nga KEDNJ-ja. Megjithatë, kjo nuk e pengon të drejtën e Bashkimit Evropian të sigurojë një nivel më të lartë mbrojtjeje, në përputhje me nenin 53 të Kartës.

Zbatimi horizontal i Kartës

Çështja e zbatimit horizontal të Kartës lidhet me pyetjen nëse dispozitat e saj mund të invokohen në mosmarrëveshje ndërmjet subjekteve private. Neni 51(1) i Kartës përcakton se ajo u drejtohet institucioneve të Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare kur ato zbatojnë të drejtën e Bashkimit Evropian, gjë që sugjeron se Karta nuk është drejtpërdrejt detyruese për subjektet private. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Karta është e parëndësishme në marrëdhëniet horizontale. Kur një mosmarrëveshje ndërmjet palëve private bie brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian — zakonisht sepse lidhet me zbatimin e legjislacionit të Bashkimit, siç janë direktivat në fushën e mosdiskriminimit ose kushteve të punës — dispozitat e Kartës mund të bëhen të zbatueshme në mënyrë të tërthortë përmes detyrimeve që e drejta e Bashkimit Evropian u imponon gjykatave kombëtare.

2.2 Moduli 2: Praktika gjyqësore në lidhje me Kartën

Objektivat e të nxënit

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të kuptojnë jurisprudencën kryesore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) në lidhje me Kartën e të Drejtave Themelore;
- të përcaktojnë në praktikë rastet kur Karta është e zbatueshme;
- të dallojnë ndërmjet të drejtave dhe parimeve përmes analizës së jurisprudencës;
- të kuptojnë rolin e gjykatave kombëtare në interpretimin dhe zbatimin e Kartës.

Ky modul ofron një përmbledhje të jurisprudencës kryesore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) lidhur me aspektet më të rëndësishme të Kartës së të Drejtave Themelore, siç janë fusha e zbatimit të Kartës dhe dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve, pasi kuptimi i këtyre çështjeve kërkon shtjellim dhe shpjegim të mëtejshëm. Moduli paraqet gjithashtu jurisprudencën tjetër relevante në lidhje me detyrimet e autoriteteve kombëtare, veçanërisht të gjykatave, për interpretimin dhe zbatimin e Kartës. Disa shembuj paraqiten më poshtë, ndërsa një përmbledhje e plotë e çështjeve kryesore (përfshirë një shpjegim të shkurtër të secilit vendim) gjendet në PJESËN IV të kurrikulës së trajnimit.

Fusha e zbatimit

GJDBE-ja ka sqaruar fushën e zbatimit të nenit 51 të Kartës përmes një sërë vendimesh. Një parim themelor që del nga kjo jurisprudencë është se Karta zbatohet sa herë që një situatë bie brenda fushës së të drejtës së Bashkimit Evropian.

Në çështjen *Kücükdeveci*, Gjykata konstatoi se legjislacioni kombëtar që bie brenda fushës së të drejtës së BE-së duhet të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtës së Bashkimit, përfshirë të drejtat themelore. Edhe pse në atë kohë Karta nuk kishte ende fuqi juridike detyruese, kjo çështje hodhi bazat për arsyetimin e mëvonshëm të mbështetur në Kartë. Jurisprudenca e mëvonshme konfirmon se Karta zbatohet jo vetëm kur shtetet anëtare zbatojnë të drejtën e BE-së, por edhe kur ato veprojnë më gjerësisht brenda fushës së saj të zbatimit.

Përmbledhje e pikave kryesore

Karta zbatohet sa herë që një masë kombëtare bie brenda fushës së zbatimit të të drejtës së BE-së, edhe kur lidhja me të drejtën e BE-së është e tërthortë, por mjaftueshmërisht relevante.

Dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve

Dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve sipas nenit 52(5) të Kartës është zhvilluar më tej në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Në çështjen *Bauer*, Gjykata konstatoi se neni 31(2) i Kartës, i cili garanton të drejtën për pushim vjetor të paguar, përbën një të drejtë që është mjaftueshëm e saktë dhe e pakushtëzuar për t'u invokuar drejtpërdrejt, madje edhe në mosmarrëveshje ndërmjet subjekteve private.

Në mënyrë të ngjashme, në çështjen *Egenberger*, Gjykata pranoi se neni 47 i Kartës, i cili garanton të drejtën për mbrojtje gjyqësore efektive, është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe mund të përdoret si bazë për të mos zbatuar dispozita të së drejtës kombëtare që bien në kundërshtim me të. Kjo çështje nxjerr në pah rolin thelbësor të gjykatave kombëtare në garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të garantuara nga Karta.

Në të kundërt, dispozitat që klasifikohen si parime sipas nenit 52(5) të Kartës kërkojnë zbatim përmes masave legislative dhe nuk mund të krijojnë, në vetvete, pretendime drejtpërdrejt të zbatueshme për individët. Megjithatë, ato vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në: interpretimin e së drejtës së Bashkimit Evropian; interpretimin e së drejtës kombëtare; kontrollin e ligjshmërisë së akteve normative dhe administrative.

Niveli i mbrojtjes

GJDBE-ja e ka interpretuar nenin 53 lidhur me nivelin e mbrojtjes në mënyrë kufizuese, veçanërisht në çështjen *Melloni*. Në atë rast, Gjykata vlerësoi se Shtetet Anëtare nuk mund të mbështeten në standarde më të larta kushtetuese kombëtare, kur kjo do të cenonte përparësinë, unitetin ose efektivitetin e së drejtës së BE-së. Si rezultat, kur e drejta e BE-së harmonizon plotësisht një fushë, autoritetet kombëtare janë të detyruara të zbatojnë nivelin e mbrojtjes të përcaktuar sipas së drejtës së BE-së, edhe nëse standardet kombëtare janë më të larta. Në të njëjtën kohë, kur e drejta e BE-së lejon diskrecion ose nuk e rregullon plotësisht një çështje, Shtetet Anëtare mund të zbatojnë ende standarde më të larta, siç parashikohet në të drejtën kombëtare ose në kushtetutat kombëtare, me kusht që kjo të mos cenojë të drejtën e BE-së. Qasja e Gjykatës pasqyron kështu një balancë ndërmjet garantimit të të drejtave themelore dhe sigurimit të zbatimit uniform të së drejtës së BE-së, ndërsa në praktikë i jep përparësi kësaj të fundit kur lindin tensione.

Situata	A mund të zbatohet një nivel më i lartë mbrojtjeje sipas standardeve kombëtare?
E drejta e Bashkimit Evropian harmonizon plotësisht fushën përkatëse	Zakonisht jo
E drejta e Bashkimit Evropian u lë hapësirë diskrecioni shteteve anëtare	Mundësisht po

Zbatimi horizontal i Kartës

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian ka sqaruar se disa dispozita të Kartës, kur janë mjaftueshëm të sakta dhe të pakushtëzuara, mund të invokohen në mosmarrëveshje horizontale ndërmjet subjekteve private. Në çështje si *Egenberger*, Gjykata ka theksuar se gjykatat kombëtare kanë detyrimin të garantojnë efektivitetin e plotë të të drejtave të mbrojtura nga Karta, përfshirë edhe rastet kur kjo kërkon moszbatimin e dispozitave të së drejtës kombëtare që bien në kundërshtim me këto të drejta në mosmarrëveshje ndërmjet individëve ose subjekteve private. Nga ana tjetër, dispozitat që klasifikohen si parime sipas nenit 52(5) të Kartës nuk mund të krijojnë, në vetvete, pretendime drejtpërdrejt të zbatueshme në marrëdhënie horizontale. Qasja e Gjykatës bazohet, pra, në dallimin ndërmjet të drejtave që mund të invokohen drejtpërdrejt dhe parimeve që nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme, duke theksuar njëkohësisht rolin qendror të gjykatave kombëtare në ndërmjetësimin e zbatimit të Kartës në mosmarrëveshjet ndërmjet subjekteve private. Në çështjen *Bauer*, Gjykata vendosi se neni 31(2) i Kartës, i cili garanton të drejtën për pushim vjetor të paguar, përbën një të drejtë mjaftueshëm të saktë dhe të pakushtëzuar për t'u invokuar drejtpërdrejt në mosmarrëveshje ndërmjet palëve private. Ky vendim konfirmon se disa dispozita të Kartës mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë horizontal.

2.3 Moduli 3: Analiza praktike e rastit

Objektivat e të nxënës

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të analizojnë raste praktike që lidhen me Kartën e të Drejtave Themelore;
- të identifikojnë dispozitat relevante të Kartës në situata konkrete;
- të zbatojnë jurisprudencën përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE);
- të strukturojnë arsyetimin juridik në çështje që lidhen me të drejtat themelore.

Ky modul bazohet në qasjen e të nxënës të bazuar në probleme (PBL) dhe përqendrohet në raste hipotetike të hartuara për të simuluar skenarë realistë gjyqësorë dhe prokurorialë.

Rastet specifike zhvillohen veçmas dhe vihen në dispozicion në PJESËN IV të kurrikulës së trajnimit, e cila përfshin të gjitha materialet mbështetëse. Ato janë hartuar me kujdes për të pasqyruar situata në të cilat ngrihen çështje lidhur me:

- zbatueshmërinë e Kartës;
- identifikimin e dispozitave përkatëse të Kartës;
- dallimin ndërmjet të drejtave dhe parimeve;
- nivelin e duhur të mbrojtjes;
- zbatimin horizontal të Kartës;
- më përgjithësisht, zbatimin e jurisprudencës së GJDBE-së.

1. A zbatohet Karta?
2. Cilat dispozita të Kartës janë relevante?
3. A përbën dispozita një të drejtë apo një parim?
4. Çfarë parashikon jurisprudenca përkatëse e GJDBE-së?
5. Cili duhet të jetë përfundimi përfundimtar juridik?

Pjesëmarrësit do të punojnë në grupe të vogla (ose individualisht) dhe do të ftohen të analizojnë rastet duke:

- përcaktuar nëse Karta zbatohet;
- identifikuar dispozitat relevante;
- vlerësuar nëse këto dispozita përbëjnë të drejta apo parime;
- zbatuar jurisprudencën përkatëse për të arritur në një përfundim juridik të argumentuar.

Qëllimi i këtij moduli është të shkojë përtej njohurive teorike dhe diskutimit analitik, duke u mundësuar pjesëmarrësve të angazhohen në arsyetim juridik dhe zbatim praktik të normave juridike. Studimet e rasteve të përfshira në PJESËN IV përmbajnë gjithashtu pyetje orientuese, të cilat mund të përdoren nga trajnerët për të udhëhequr pjesëmarrësit drejt zgjidhjeve të mundshme.

2.4 Moduli 4: Diskutim

Objektivat e të nxënës

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- të paraqesin dhe diskutojnë arsyetimin juridik në çështje që lidhen me Kartën e të Drejtave Themelore;
- të krahasojnë qasje të ndryshme në interpretimin e Kartës;
- të identifikojnë sfidat më të zakonshme në zbatimin e Kartës;
- të reflektojnë mbi zbatimin praktik të Kartës në praktikën gjyqësore kombëtare.

Moduli përmbyllës përbëhet nga një diskutim plenar, gjatë të cilit diskutohen rezultatet e punës në grup dhe/ose individuale. Gjatë kësaj seance, secili grup paraqet analizën e tij mbi rastet hipotetike. Kjo u mundëson pjesëmarrësve të krahasojnë qasje të ndryshme ndaj të njëjtit problem juridik dhe të reflektojnë mbi linja alternative arsyetimi. Më pas, trajnuesi udhëheq diskutimin duke theksuar pikat kryesore, duke sqaruar çdo keqkuptim dhe duke e lidhur diskutimin sërish me dispozitat përkatëse të Kartës dhe jurisprudencën e GJDBE-së.

Vëmendje e veçantë i kushtohet çdo sfide të përsëritur, si përcaktimi nëse Karta zbatohet në një situatë të caktuar dhe dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve në praktikë. Kur është e nevojshme, trajnuesi jep shpjegime shtesë për të siguruar që këto çështje të kuptohen qartë. Për më tepër, pjesëmarrësit ftohen të reflektojnë mbi mënyrën se si njohuritë dhe aftësitë e zhvilluara gjatë trajnimit mund të zbatohen në punën e tyre.

Ndërsa ky modul nuk mund të përgatitet në detaje paraprakisht, pasi do të varet në masë të madhe nga pyetjet dhe reflektimet e ngritura nga pjesëmarrësit, më poshtë paraqiten disa mesazhe kryesore që mund të përmenden:

Pikë kyçe për diskutim

Gjykatat kombëtare luajnë një rol qendror në garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të garantuara nga Karta dhe në balancimin e standardeve kombëtare juridike me kërkesat e së drejtës së Bashkimit Evropian.

- Karta zbatohet vetëm kur një situatë bie brenda fushës së zbatimit të së drejtës së BE-së (neni 51 i Kartës së të Drejtave Themelore), por kjo fushë interpretohet gjerësisht dhe përfshin situatat kur autoritetet kombëtare veprojnë brenda fushës së rregulluar nga e drejta e BE-së.
- Përcaktimi nëse Karta zbatohet kërkon një vlerësim konkret të lidhjes ndërmjet masës kombëtare dhe së drejtës së BE-së. Situatat thjesht të brendshme mbeten jashtë fushës së saj të zbatimit.
- Dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve sipas nenit 52(5) të Kartës së të Drejtave Themelore është thelbësor për të përcaktuar nëse një dispozitë mund të invokohet drejtpërdrejt përpara gjykatës.
- Të drejtat e Kartës duhet të respektohen dhe mund të përdoren drejtpërdrejt si bazë ligjore, përfshirë në disa situata horizontale, me kusht që ato të jenë mjaftueshëm të sakta dhe të pakushtëzuara.

- Parimet e Kartës kërkojnë zbatim përmes legjislacionit të BE-së ose legjislacionit kombëtar dhe nuk mund, në vetvete, të krijojnë pretendime drejtpërdrejt të zbatueshme, por mbeten relevante për interpretimin dhe kontrollin.
- Gjykatat kombëtare luajnë një rol qendror në sigurimin e mbrojtjes efektive të të drejtave themelore, përfshirë detyrimin për të interpretuar të drejtën kombëtare në përputhje me të drejtën e BE-së dhe, kur është e nevojshme, për të mos zbatuar dispozitat që bien ndesh me të.
- Niveli i mbrojtjes sipas Kartës nuk u lejon automatikisht Shteteve Anëtare të zbatojnë standarde më të larta kombëtare, kur kjo do të cenonte përparësinë, unitetin dhe efektivitetin e së drejtës së BE-së.
- Karta mund të jetë relevante në mosmarrëveshjet ndërmjet palëve private, kur situata bie brenda fushës së zbatimit të së drejtës së BE-së dhe kur dispozita përkatëse cilësohet si e drejtë.
- Besimi i ndërsjellë dhe njohja e ndërsjellë janë parime themelore të së drejtës së BE-së, por ato nuk janë absolute dhe mund të kufizohen kur ekziston një rrezik real i shkeljes së të drejtave themelore.
- Në çështjet e njohjes së ndërsjellë, autoriteteve kombëtare mund t'u kërkohej të vlerësojnë si mangësitë sistemike, ashtu edhe situatën individuale të personit përkatës, përpara se të marrin një vendim.

III. METODOLOGJIA E TRAJNIMIT

3. Metodologjia e Trajnimit

Këshillë për trajnerin

Gjatë diskutimeve, trajnerët duhet të inkurajojnë pjesëmarrësit të shpjegojnë jo vetëm përfundimet e tyre, por edhe procesin e arsyetimit që i ka çuar drejt këtyre përfundimeve. Fokusi duhet të mbetet tek arsyetimi juridik i strukturuar dhe zbatimi praktik i normave juridike në situata konkrete.

3.1 Roli dhe Përgjegjësitë e Trajnerëve Kombëtarë

Trajnuesit kombëtarë kanë për detyrë të sigurojnë transferimin e njohurive dhe aftësive lidhur me zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore. Roli i tyre shkon përtej ofrimit të përmbajtjes dhe përfshin lehtësimin e proceseve të të nxënës, kontekstualizimin e materialit juridik dhe udhëzimin metodologjik.

Në këtë drejtim, trajnuesit kombëtarë janë përgjegjës për të siguruar që Karta të paraqitet në mënyrë të saktë dhe në përputhje me zhvillimet më të fundit. Fokusi është te fusha e saj e zbatimit dhe te dallimi ndërmjet të drejtave, të cilat janë të justiciueshme, dhe parimeve, të cilat kërkojnë transpozim. Ata pritët gjithashtu të vendosin normat e Kartës dhe jurisprudencën e GJDBE-së brenda kuadrit ligjor kombëtar dhe praktikës gjyqësore.

Për më tepër, trajnuesit kanë edhe një rol pedagogjik. Ata duhet të lehtësojnë procese ndërvepruese të të nxënës, duke përfshirë udhëheqjen e pjesëmarrësve në analizën e rasteve hipotetike, nxitjen e arsyetimit juridik të pavarur dhe promovimin e dialogut.

3.2 Strukturimi dhe Zhvillimi i një Sesioni Kombëtar Trajnimi

Çdo sesion kombëtar trajnimi duhet të lehtësojë një proces të strukturuar dhe progresiv të të nxënës, duke kaluar nga kuptimi konceptual drejt zbatimit praktik të njohurive. Për secilin sesion janë vënë në dispozicion materiale mbështetëse, të përfshira në anekset përkatëse të këtij materiali.

Sesioni i trajnimit zhvillohet në katër faza.

Së pari, sesioni fillon me një komponent hyrës teorik-doktrinar. Kjo pjesë synon të ofrojë një prezantim të shkurtër të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe një pasqyrë të përmbledhur të dispozitave më të rëndësishme të saj, me fokus të veçantë tek:

- fusha e zbatimit të Kartës (neni 51 i Kartës);
- parimet e interpretimit të Kartës (neni 52 i Kartës);
- kategorizimi i dispozitave të Kartës në të drejta, parime dhe deklarime, me referencë të veçantë në nenin 52(5) të Kartës;
- niveli i mbrojtjes së të drejtave themelore dhe marrëdhënia e Kartës me standardet kombëtare dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (nenet 52(3) dhe 53 të Kartës);
- zbatimi horizontal i Kartës.

Së dyti, trajnuesit japin një përmbledhje të çështjeve kryesore lidhur me pikat e renditura më sipër. Në këtë pjesë, paraqiten dhe diskutohen vendimet më relevante të GJDBE-së. Fokusi qëndron te arsyetimi juridik i Gjykatës, pasojat praktike për autoritetet kombëtare dhe kriteret e përdorura për të përcaktuar nëse një dispozitë mund të invokohet drejtpërdrejt ose përbën një parim. Përmbledhja e jurisprudencës përkatëse jepet në Aneks.

Së treti, trajnimi kalon te të nxënit e bazuar në probleme dhe zbatimi praktik. Pjesëmarrësit punojnë në grupe të vogla ose individualisht mbi raste hipotetike që pasqyrojnë skenarë realistë. Studimet e rasteve gjenden në Aneks. Kopjet e printuara u shpërndahen pjesëmarrësve dhe ata ftohen t'i "zgjidhin" rastet.

Këto ushtrime kërkojnë që pjesëmarrësit të vlerësojnë zbatueshmërinë e Kartës, të identifikojnë dispozitat përkatëse, të përcaktojnë natyrën e tyre juridike dhe të zbatojnë jurisprudencën përkatëse për të arritur në një përfundim të arsyetuar. Trajnuesi mund të përdorë pyetjet udhëzuese të parashikuara në Aneks për të lehtësuar ushtrimin.

Në fund, seanca përmbyllet me një diskutim plenar. Gjetjet e grupeve diskutohen bashkërisht dhe trajnuesit sintetizojnë pikat kryesore dhe sqarojnë çdo çështje të mbetur pezull.

Kjo strukturë siguron një ekuilibër ndërmjet përvetësimit të njohurive, analizës juridike dhe zhvillimit të aftësive praktike.

3.3 Teknikat e Facilitimit për Profesionistët e së Drejtës

Metodologjia e trajnimit bazohet në teknika lehtësimi të përshtatura posaçërisht për profesionistët me përvojë në fushën juridike. Në vend që të ndjekë një qasje thjesht instruktive, kjo metodologji synon të angazhojë pjesëmarrësit në mënyrë aktive dhe të mbështetet në përvojën e tyre profesionale.

Metodat kryesore janë pyetjet udhëzuese dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet kolegëve, pasi ato u mundësojnë pjesëmarrësve të "mësojnë përmes praktikës", duke kontribuar njëkohësisht me përvojën e tyre profesionale. Trajnerët ofrojnë gjithashtu komente dhe udhëzime të strukturuar, duke dhënë sqarime specifike kur kërkohen, ndërkohë që ruajnë pavarësinë e procesit të arsyetimit të pjesëmarrësve.

Përdorimi i metodës së të nxënit të bazuar në zgjidhjen e problemeve (*Problem-Based Learning – PBL*), veçanërisht në Modulin 3 dhe Modulin 4, siguron që trajnimi të mbetet i orientuar nga pjesëmarrësit dhe i lidhur ngushtë me arsyetimin gjyqësor në praktikë. Kjo qasje mbështetet në katër parime të të nxënit, të nxjerra nga teoria konstruktiviste e të nxënit: të nxënit konstruktiv, kontekstual, bashkëpunues dhe i vetëdrejtuar (constructive, contextual, collaborative and self-directed learning -CCCS). Trajnerët duhet të monitorojnë vazhdimisht dinamikën e grupeve dhe të ndërhyjnë në mënyrë selektive, me qëllim ruajtjen e fokusit dhe garantimin e saktësisë juridike.

3.4 Axbenda për Sesionet Kombëtare Pasuese të Trajnimit

Trajnerët kombëtarë të trajnuar pritët, në thelb, të riprodhojnë trajnimin fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët publikë në nivel kombëtar. Qëllimi i kësaj qasjeje është të sigurohet qëndrueshmëri metodologjike, standarde të unifikuara të zhvillimit të trajnimit. Megjithatë, përshtatje të kufizuara me kontekstin juridik kombëtar janë të mundshme, kur ato janë të nevojshme ose të dobishme.

Së pari, trajnerët duhet të sigurohen që pjesëmarrësit të njihen me tekstin e Kartës dhe të prezantojnë kuadrin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, duke përfshirë fushën e zbatimit të saj, dispozitat interpretuese, kategorizimin e dispozitave të Kartës në të drejta, parime dhe deklarime, dispozitat që lidhen me nivelin e mbrojtjes. Gjithashtu, duhet të përmendet mundësia e zbatimit horizontal të Kartës. Ky prezantim duhet të zhvillohet duke përdorur të njëjtën strukturë konceptuale, terminologji, tabela dhe materiale ndihmëse të ofruara gjatë trajnimit fillestar.

Së dyti, trajnerët duhet të paraqesin një pasqyrë të jurisprudencës kryesore të GJDBE-së.

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet vendimeve që sqarojnë mundësinë e invokimit të drejtpërdrejtë të të drejtave të Kartës, natyrën juridike të parimeve të Kartës sipas nenit 52(5), rolin e gjykatave kombëtare dhe prokurorëve në zbatimin e standardeve të Kartës.

Së treti, trajnimi duhet të përfshijë ushtrime të bazuara në metodologjinë e të nxënit përmes zgjidhjes së problemeve. Trajnerët duhet të lehtësojnë punën në grupe të vogla ose individualisht, bazuar në raste studimore hipotetike të përdorura në trajnimin fillestar ose të modeluara mbi to. Format i PBL duhet të ruhet dhe të përfshijë identifikimin e çështjeve juridike, punën në grupe të vogla ose individualisht dhe diskutimin plenar. Ruajtja e këtij formati është e rëndësishme për të siguruar një proces aktiv të të nxënit. Fokusi i këtij moduli nuk është transmetimi i njohurive në formën e një leksioni klasik, por zbatimi i njohurive të fituara në situata konkrete, ku përgjegjësia kryesore për analizën bie mbi pjesëmarrësit, ndërsa trajneri luan një rol udhëzues dhe lehtësues.

Në fund, trajnerët duhet të udhëheqin një diskutim plenar që synon konsolidimin e rezultateve të të nxënit, sqarimin e çështjeve doktrinare dhe jurisprudenciale dhe forcimin e zbatimit praktik të Kartës.

Pjesëmarrësve duhet t'u jepet mundësia të lidhin njohuritë e fituara gjatë trajnimit me praktikën e tyre të përditshme profesionale. Megjithatë trajnerët kombëtarë mund të përshtatin, ose edhe të ndryshojnë, shembujt, skenarët faktikë ose referencat ndaj së drejtës kombëtare, ata duhet të ruajnë të njëjtën qasje metodologjike gjatë zhvillimit të trajnimeve.

IV. MATERIALET E TRAJNIMIT DHE ANEKSET

Shënim praktik për trajnerët

Studimet e rasteve mund të përshtaten në mënyrë të kufizuar me kontekstin juridik kombëtar ose me zhvillimet aktuale, duke ruajtur gjithmonë të njëjtën qasje metodologjike dhe të njëjtat objektiva të të nxënit.

4.1 Tabelë: Klasifikimi i Dispozitave të Përzgjedhura të Kartës (Moduli 1)

Dispozita	Objekti	Natyra	Shpjegimi
Neni 1 i Kartës	Dinjiteti njerëzor	E drejtë	E drejtë themelore, e pakushtëzuar dhe drejtpërdrejt e invokueshme.
Neni 7 i Kartës	Respektimi i jetës private dhe familjare	E drejtë	Korrespondon me nenin 8 të KEDNJ-së; drejtpërdrejt e zbatueshme.
Neni 8 i Kartës	Mbrojtja e të dhënave personale	E drejtë	E drejtë individuale e shprehur qartë dhe me përmbajtje të përcaktuar.
Neni 10 i Kartës	Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë	E drejtë	E drejtë klasike themelore.
Neni 11 i Kartës	Liria e shprehjes	E drejtë	Mund të invokohet drejtpërdrejt; korrespondon me KEDNJ-në.
Neni 21 i Kartës	Mosdiskriminimi	E drejtë	Ndalim me fushë të gjerë veprimi, por drejtpërdrejt i zbatueshëm.
Neni 31(2) i Kartës	Pushimi vjetor i paguar	E drejtë	Njohur nga jurisprudenca si e drejtë me efekt të drejtpërdrejtë.
Neni 47 i Kartës	E drejta për mjet juridik efektiv dhe proces të rregullt gjyqësor	E drejtë	Garanci procedurale themelore; drejtpërdrejt e zbatueshme.
Neni 27 i Kartës	E drejta e punëmarrësve për informim dhe konsultim	Parim	Kërkon zbatim përmes legjislacionit të BE-së ose atij kombëtar.
Neni 28 i Kartës	Negocimi dhe veprimi kolektiv	Natyre hibride	Disa elemente mund t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, por varen nga legjislacioni përkatës.
Neni 34 i Kartës	Sigurimet shoqërore dhe ndihma sociale	Parim	Dispozitë programatike që kërkon konkretizim legjislativ.
Neni 35 i Kartës	Kujdesi shëndetësor	Parim	Shpreh një objektiv politikash publike më shumë sesa një pretendim individual.
Neni 36 i Kartës	Akresi në shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik	Parim	Varet nga kuadri rregullator i BE-së dhe ai kombëtar.

Neni 37 i Kartës	Mbrojtja e mjedisit	Parim	Dispozitë qartësisht programatike dhe e orientuar drejt politikave publike.
Neni 22 i Kartës	Diversiteti kulturor, fetar dhe gjuhësor	Deklarim	Ka karakter deklarativ; nuk krijon një të drejtë individuale të qartë.
Neni 24 i Kartës	Të drejtat e fëmijës	Natyre hibride	Përmban si të drejta drejtpërdrejt të zbatueshme, ashtu edhe parime.

4.2 Pasqyrë e Jurisprudencës (Moduli 2)

1. Çështja C-299/95 – Kremzow (1997, para hyrjes në fuqi të Kartës)

Faktet

Z. Kremzow u shpall fajtor për vrasje nga një gjykatë austriake dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Ai pretendoi se e drejta e tij për një proces të rregullt gjyqësor (si parim i përgjithshëm i së drejtës së Bashkimit Evropian) ishte shkelur, veçanërisht për shkak se nuk ishte dëgjuar në mënyrë të duhur gjatë procedurave gjyqësore. Për të mbështetur pretendimin e tij, ai u mbështet në të drejtën primare të Bashkimit Evropian, pra në Traktatet e BE-së, duke argumentuar se ndalimi i tij i paligjshëm kufizonte lirinë e tij të lëvizjes brenda Bashkimit Evropian. Ai iu referua gjithashtu një vendimi të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në të cilin ishte konstatuar shkelja e nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (e drejta për një proces të rregullt gjyqësor).

Vendimi

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian vendosi se e drejta e Bashkimit Evropian nuk ishte e zbatueshme në këtë rast, pasi situata konkrete nuk kishte një lidhje të mjaftueshme me të drejtën e Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, të drejtat themelore të garantuara nga e drejta e Bashkimit Evropian nuk mund të invokoheshin.

Arsyetimi

Gjykata shqyrtoi nëse situata e aplikantit binte brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian. Ajo pranoi se liria e lëvizjes është një e drejtë e mbrojtur nga e drejta e Bashkimit Evropian, por theksoi se shkelja e pretenduar – konkretisht dënimi penal i paligjshëm – rregullohej tërësisht nga e drejta kombëtare. Në fakt, aplikanti ishte dënuar për veprën penale të vrasjes dhe për mbajtje të paligjshme të armës së zjarrit në bazë të dispozitave të së drejtës kombëtare, të cilat nuk kishin si qëllim zbatimin ose garantimin e respektimit të së drejtës së Bashkimit Evropian. Kufizimi i lirisë së lëvizjes ishte vetëm një pasojë e tërthortë e dënimit penal dhe jo rezultat i zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian apo i një mase kombëtare që synonte zbatimin e saj. Për këtë arsye, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ekzistonte asnjë lidhje ndërmjet masës kombëtare dhe së drejtës së Bashkimit Evropian, dhe se të drejtat themelore të Bashkimit nuk mund të zbatoheshin në procedura penale që kishin karakter thjesht të brendshëm.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje vendos një qasje kufizuese: Karta (dhe, më herët, parimet e përgjithshme) zbatohet vetëm kur ekziston një lidhje reale dhe e drejtpërdrejtë me të drejtën e Bashkimit Evropian.

2. Çështja C-144/04 – Mangold (2005, para hyrjes në fuqi të Kartës)

Faktet

Legjislacioni gjerman lejonte lidhjen e kontratave të punës me afat të caktuar për punëmarrësit mbi moshën 52 vjeç pa kërkuar një justifikim objektiv. Z. Mangold, i punësuar në bazë të një kontrate të tillë, pretendoi se kjo dispozitë përbente diskriminim të pajustificuar për shkak të moshës, në kundërshtim me parimin e përgjithshëm të mosdiskriminimit në të drejtën e Bashkimit Evropian, siç pasqyrohet edhe në Direktivën 2000/78/KE.

Vendimi

Gjykata vendosi se dispozita kombëtare ishte në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit për shkak të moshës dhe se ajo duhej të mos zbatohet nga gjykata kombëtare.

Arsyetimi

GJDBE konstatoi se masa kombëtare binte brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian, pasi lidhej me një direktivë që rregullonte trajtimin e barabartë në marrëdhëniet e punës. Megjithatë afati për transpozimin e Direktivës 2000/78/KE nuk kishte përfunduar ende, Gjykata vlerësoi se parimi i mosdiskriminimit për shkak të moshës tashmë përbente një parim të përgjithshëm të së drejtës së Bashkimit Evropian. Gjykata arsyetoi se lejimi i vazhdimit të zbatimit të dispozitës kombëtare do të cenonte efektivitetin e së drejtës së Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, gjykatat kombëtare ishin të detyruara të garantonin respektimin e këtij parimi duke mos zbatuar dispozitat kombëtare që binin në kundërshtim me të.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje prezanton idenë se të drejtat themelore, si parime të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit Evropian, mund të kenë efekt të drejtpërdrejtë edhe përpara se Karta të bëhet juridikisht detyruese.

3. Çështja C-555/07 – Küçükdeveci (2010)

Faktet

Sipas legjislacionit gjerman, periudhat e punësimit të kryera përpara moshës 25 vjeç nuk merreshin parasysh gjatë llogaritjes së afatit të njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës. Znj. Küçükdeveci, e cila kishte filluar punën përpara moshës 25 vjeç, përfitoi një afat më të shkurtër njoftimi dhe pretendoi se kjo përbente diskriminim për shkak të moshës.

Vendimi

Gjykata vendosi se dispozita kombëtare ishte e papajtueshme me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe duhej të mos zbatohet.

Arsyetimi

Gjykata vlerësoi se dispozita kombëtare binte brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian, pasi kishte të bënte me kushtet e punësimit të rregulluara nga Direktiva 2000/78/KE. Ajo konstatoi se përjashtimi i periudhave të punësimit vetëm për shkak të moshës përbente një formë diskriminimi të pajustificuar. Gjykata theksoi se parimi i mosdiskriminimit është një parim i përgjithshëm i së drejtës së Bashkimit Evropian, i pasqyruar tashmë edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, gjykatat kombëtare janë të detyruara të mos zbatojnë dispozitat e së drejtës kombëtare që bien në kundërshtim me këtë parim, edhe kur mosmarrëveshja zhvillohet ndërmjet subjekteve private.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje konfirmon efektin horizontal të arsyetimit të bazuar në të drejtat themelore dhe forcon rolin e gjykatave kombëtare në rastet që bien brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian.

4. Çështja C-279/09 – DEB (2010)

Faktet

Një shoqëri tregtare kërkoi ndihmë juridike falas për të ngritur një padi, por kërkesa iu refuzua sipas legjislacionit gjerman, i cili e kufizonte përfitimin e ndihmës juridike vetëm për personat fizikë. Shoqëria pretendoi se ky kufizim e pengonte të ushtronte në mënyrë efektive të drejtën e aksesit në gjykatë.

Vendimi

Gjykata vendosi se neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore mund të zbatohet edhe ndaj personave juridikë dhe se aksesit në drejtësi duhet të jetë efektiv.

Arsyetimi

Gjykata shqyrtoi nëse refuzimi i ndihmës juridike e bënte të pamundur ose tepër të vështirë ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit Evropian. Ajo theksoi se e drejta për një mjet juridik efektiv kërkon që aksesit në gjykatë të jetë real dhe efektiv në praktikë. Gjykata arsyetoi se edhe personat juridikë mund të kenë nevojë për ndihmë juridike në rrethana të caktuara dhe se një përjashtim absolut i tyre nga kjo e drejtë mund të cenonte garancitë e nenit 47 të Kartës. Për rrjedhojë, gjykatat kombëtare duhet të vlerësojnë nëse kufizime të tilla janë proporcionale.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje zgjeron fushën e mbrojtjes së nenit 47 të Kartës dhe sqaron se të drejtat themelore duhet të jenë praktike dhe efektive, e jo thjesht teorike ose iluzore. Ky është gjithashtu standardi i ndjekur nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në interpretimin e së drejtës për një mjet juridik efektiv sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5. Çështja C-617/10 – Åkerberg Fransson (2013)

Faktet

Z. Fransson iu nënshtrua njëkohësisht sanksioneve tatimore dhe procedimeve penale për mashtrim në lidhje me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Ai pretendoi se kjo situatë përbënte shkelje të parimit *ne bis in idem*, të garantuar nga neni 50 i Kartës së të Drejtave Themelore.

Vendimi

Gjykata vendosi se Karta ishte e zbatueshme në këtë rast, pasi çështja kishte të bënte me TVSH-në, e cila rregullohet nga e drejta e Bashkimit Evropian.

Arsyetimi

Gjykata u përqendrua në analizën nëse masat kombëtare kishin lidhje me të drejtën e Bashkimit Evropian. Ajo konstatoi se TVSH-ja është një fushë e harmonizuar në nivel të Bashkimit Evropian dhe se sanksionet kombëtare që lidhen me zbatimin e rregullave për TVSH-në bien brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit. Gjykata refuzoi një interpretim të ngushtë të nenit 51 të Kartës dhe sqaroi

se Karta zbatohet sa herë që legjislacioni kombëtar lidhet me të drejtën e Bashkimit Evropian, edhe në mënyrë të tërthortë. Kjo qasje siguron mbrojtje të njëtrajtshme të të drejtave themelore në fushat e rregulluara nga e drejta e Bashkimit Evropian.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje vendos një interpretim të gjerë të fushës së zbatimit të Kartës.

6. Çështja C-399/11 – Melloni (2013)

Faktet

Z. Melloni kundërshtoi dorëzimin e tij në bazë të një Urdhri Evropian Arresti, duke argumentuar se Kushtetuta spanjolle garantonte një nivel më të lartë mbrojtjeje të të drejtave themelore. Ai pretendoi se e drejta kushtetuese spanjolle nuk lejonte gjykimin në mungesë (trial in absentia), ndërsa në rastin e tij ai ishte dënuar pa qenë fizikisht i pranishëm në gjykim, megjithëse kishte qenë i informuar për procesin dhe ishte përfaqësuar nga avokatë të zgjedhur prej tij.

Vendimi

Gjykata vendosi se Spanja nuk mund të mbështetej në standarde më të larta kombëtare të mbrojtjes nëse kjo do të cenonte zbatimin efektiv të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Arsyetimi

Gjykata analizoi nenin 53 të Kartës dhe marrëdhënien e tij me të drejtën e Bashkimit Evropian. Ajo konstatoi se lejimi i shteteve anëtare për të zbatuar standarde më të larta kombëtare në këtë kontekst do të cenonte unitetin dhe efektivitetin e së drejtës së Bashkimit Evropian, veçanërisht në sistemet e bazuara në njohjen reciproke të vendimeve gjyqësore. Për këtë arsye, Gjykata i dha përparësi standardeve të Bashkimit Evropian në rastet kur harmonizimi është i plotë.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje sqaron kufijtë e autonomisë kushtetuese të shteteve anëtare në kuadër të Kartës së të Drejtave Themelore.

7. Çështja C-206/13 – Siragusa (2014)

Faktet

Z. Siragusa kishte kryer punime ndërtimore në një zonë të mbrojtur dhe u mbështet në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian për të kundërshtuar sanksionet e vendosura ndaj tij. Ai invokoi të drejtën e pronës, të garantuar nga neni 17 i Kartës, për të kundërshtuar një urdhër për prishjen e ndërtimeve të kryera pa autorizim.

Vendimi

Gjykata vendosi se Karta nuk ishte e zbatueshme në këtë rast.

Arsyetimi

Gjykata shqyrtoi nëse masa kombëtare përbënte zbatim të së drejtës së Bashkimit Evropian. Ajo konstatoi se lidhja me të drejtën mjedisore të Bashkimit Evropian ishte tepër e tërthortë. Rregullat kombëtare ndiqnin objektiva të pavarura të së drejtës kombëtare dhe nuk ishin të kërkuara nga e drejta e Bashkimit Evropian. Gjykata theksoi se jo çdo situatë që lidhet me një fushë të rregulluar gjerësisht

nga e drejta e Bashkimit Evropian aktivizon automatikisht zbatimin e Kartës. Për këtë qëllim, kërkohet një lidhje mjaftueshëm e drejtpërdrejtë ndërmjet masës kombëtare dhe së drejtës së Bashkimit Evropian.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje saktëson kufijtë e zbatimit të nenit 51 të Kartës.

8. Çështja C-176/12 – AMS (2014)

Faktet

Çështja kishte të bënte me përfaqësimin e punëmarrësve dhe mbështetjen në nenin 27 të Kartës, i cili parashikon të drejtën e punëmarrësve për informim dhe konsultim brenda ndërmarrjes. Dispozita parashikon si vijon: “Punëmarrësve ose përfaqësuesve të tyre duhet t’u garantohet, në nivelet përkatëse, informimi dhe konsultimi në kohë të përshtatshme, në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara nga e drejta e Bashkimit Evropian dhe nga legjislacionet dhe praktikat kombëtare.”

Vendimi

Gjykata vendosi se neni 27 i Kartës përbën një parim dhe nuk mund të invokohet drejtpërdrejt.

Arsyetimi

Gjykata analizoi formulimin dhe natyrën juridike të nenit 27 të Kartës dhe arriti në përfundimin se kjo dispozitë kërkon zbatim të mëtejshëm përmes legjislacionit. Për rrjedhojë, ajo nuk ka shkallën e saktësisë së nevojshme për të prodhuar efekt të drejtpërdrejtë. Gjykata theksoi rëndësinë e dallimit të parashikuar në nenin 52(5) të Kartës ndërmjet të drejtave dhe parimeve dhe vendosi se parimet, në vetvete, nuk mund të shërbejnë si bazë për moszbatimin e dispozitave të së drejtës kombëtare.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo është një çështje udhëheqëse mbi dallimin ndërmjet të drejtave dhe parimeve sipas Kartës.

9. Çështjet e Bashkuara C-404/15 dhe C-659/15 PPU – Aranyosi dhe Căldăraru (2016)

Faktet

Çështjet kishin të bënin me dy persona ndaj të cilëve ishin lëshuar Urdhra Evropiane Arresti nga Hungaria dhe Rumania. Autoriteti gjyqësor ekzekutues në Gjermani kishte shqetësime serioze lidhur me kushtet e paraburgimit dhe burgimit në shtetet anëtare lëshuese, bazuar në raporte të organeve ndërkombëtare që tregonin mbipopullim dhe kushte të papërshtatshme në institucionet e ndalimit. Personat e përfshirë argumentuan se, nëse do të dorëzoheshin, ata do të përballeshin me kushte ndalimi që mund të përbënin trajtim çnjerëzor ose degradues, në kundërshtim me nenin 4 të Kartës.

Vendimi

Gjykata vendosi se ekzekutimi i një Urdhri Evropian Arresti duhet të shtyhet kur ekziston një rrezik real që personi i kërkuar t’i nënshtrohet trajtimit çnjerëzor ose degradues. Ajo përcaktoi një test me dy hapa për vlerësimin e këtij rreziku.

Arsyetimi

Gjykata fillimisht ripohoi se sistemi i Urdhrit Evropian të Arrestimit bazohet në parimin e besimit të ndërsjellë ndërmjet shteteve anëtare, i cili kërkon që vendimet gjyqësore të njihen dhe ekzekutohen reciprokisht. Megjithatë, ajo theksoi se besimi i ndërsjellë nuk është absolut dhe duhet të pajtohet

me mbrojtjen e të drejtave themelore. Neni 4 i Kartës, i cili ndalon torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor apo degradues, ka karakter absolut dhe nuk lejon kufizime.

Në këtë kuadër, Gjykata zhvilloi një test me dy hapa:

1. Autoriteti gjyqësor ekzekutues, pra gjykata kombëtare, duhet të vlerësojë nëse ekzistojnë prova objektive, të besueshme, specifike dhe të përditësuara në mënyrë të duhur për mangësi sistemike ose të përgjithësuara në kushtet e ndalimit në shtetin anëtar lëshues.
2. Nëse këto mangësi konstatohen, autoriteti duhet të vlerësojë më tej nëse ekziston një rrezik real që personi konkret të ekspozohet ndaj një trajtimi të tillë.

Gjykata theksoi se një konstatim i përgjithshëm i mangësive nuk është i mjaftueshëm në vetvete. Kërkohej një vlerësim individual i situatës së personit të prekur. Nëse rreziku nuk mund të përjashtohet, ekzekutimi i Urdhrit Evropian të Arrestimit duhet të shtyhet dhe duhet të kërkohej informacion shtesë nga shteti lëshues. Arsyeimi i Gjykatës pasqyron një balancë të kujdesshme ndërmjet ruajtjes së efektivitetit të njohjes reciproke dhe garantimit që të drejtat themelore, veçanërisht të drejtat absolute, të mos cenohen.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo është një çështje udhëheqëse mbi kufijtë e besimit të ndërsjellë dhe mbi kërkesën për një vlerësim me dy hapa në çështje të tilla: vlerësimin e mangësive sistemike dhe vlerësimin individual të rrezikut për personin konkret.

10. Çështja C-601 / 15 PPU – J.N. (2016)

Faktet

Çështja kishte të bënte me një shtetas të një vendi të tretë, i cili kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në Holandë, por më pas ishte ndaluar në bazë të legjislacionit kombëtar që lejonte ndalimin për arsye të rendit publik dhe sigurisë kombëtare. Aplikanti pretendoi se ndalimi i tij cenonte të drejtat e tij themelore, veçanërisht të drejtën për liri të garantuar nga neni 6 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Gjykata kombëtare kërkoi nga GJDBE të sqaronte nëse një ndalim i tillë ishte në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian, përfshirë Kartën dhe dispozitat përkatëse të së drejtës së BE-së në fushën e azilit, si dhe se si këto dispozita duhet të interpretohen në dritën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Vendimi

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian vendosi se ndalimi për arsye të rendit publik dhe sigurisë kombëtare mund të jetë në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian, me kusht që të respektojnë kërkesat e Kartës, veçanërisht nenin 6 të saj, i interpretuar në dritën e nenit 5 të KEDNJ-së.

Arsyetimi

Gjykata fillimisht konfirmoi se e drejta për liri e garantuar nga neni 6 i Kartës korrespondon me të drejtën e garantuar nga neni 5 i KEDNJ-së. Për këtë arsye, ajo iu referua nenit 52(3) të Kartës, i cili kërkon që të drejtat e Kartës që korrespondojnë me të drejtat të garantuara nga KEDNJ-ja të kenë të njëjtin kuptim dhe të njëjtën fushë mbrojtjeje. Gjykata theksoi se KEDNJ-ja vendos një standard minimal mbrojtjeje, i cili duhet të respektohet gjatë interpretimit të Kartës. Për këtë qëllim, ajo iu referua jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të sqaruar kushtet në të cilat ndalimi mund të konsiderohet i ligjshëm. Njëkohësisht, Gjykata theksoi se interpretimi i së drejtës së Bashkimit Evropian duhet të ruajë autonominë e rendit juridik të Bashkimit. Prandaj, ajo shqyrtoi nëse leg-

jislacioni përkatës i Bashkimit Evropian (në këtë rast Direktiva për Kushtet e Pritjes) ofronte një bazë juridike mjaftueshëm të qartë për ndalimin dhe nëse masa respektonte parimin e proporcionalitetit.

Gjykata arriti në përfundimin se ndalimi mund të justifikohet vetëm nëse është rreptësisht i nevojshëm, proporcional dhe i bazuar në një vlerësim individual të sjelljes së aplikantit, duke marrë në konsideratë seriozitetin e kërcënimit ndaj rendit publik ose sigurisë kombëtare. Ky arsyetim ilustron mënyrën se si funksionon në praktikë neni 52(3) i Kartës: ai siguron harmonizimin me standardet e KEDNJ-së, duke i lejuar njëkohësisht GJDBE-së të interpretojë dhe zbatojë të drejtat e Kartës brenda kuadrit specifik të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje sqaron rolin e nenit 52(3) të Kartës në harmonizimin e interpretimit të të drejtave të Kartës me KEDNJ-në si standard minimal mbrojtjeje, duke ruajtur njëkohësisht autonominë e së drejtës së Bashkimit Evropian. Ajo konfirmon gjithashtu se kufizimet e të drejtave themelore, siç është e drejta për liri, duhet të jenë rreptësisht të nevojshme, proporcionale dhe të bazuara në një vlerësim individual të situatës konkrete.

11. Çështja C-414/16 – Egenberger (2018)

Faktet

Një kandidate për punë kundërshtoi një kërkesë me karakter fetar të vendosur nga një punëdhënës privat si kusht për punësim.

Vendimi

Gjykata vendosi se neni 47 i Kartës së të Drejtave Themelore (e drejta për një mjet juridik efektiv dhe për një proces të rregullt gjyqësor) duhet të garantohet.

Arsyetimi

Gjykata konstatoi se çështja binte brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian për shkak të direktivave kundër diskriminimit. Ajo theksoi se gjykatat kombëtare duhet të garantojnë kontroll gjyqësor efektiv dhe nuk mund të mbështeten në dispozita kombëtare që kufizojnë një kontroll të tillë. Gjykata nënvizoi se të drejtat e garantuara nga Karta mund të kërkojnë moszbatimin e dispozitave kombëtare që bien në kundërshtim me to.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje forcon zbatimin horizontal të të drejtave të Kartës.

12. Çështjet e Bashkuara C-569/16 dhe C-570/16 – Bauer (2018)

Faktet

Çështja kishte të bënte me pagesën për pushimin vjetor të papërdorur pas vdekjes së punëmarrësit..

Vendimi

Gjykata vendosi se neni 31(2) i Kartës (e drejta për kushte të drejta dhe të barabarta pune) garanton një të drejtë drejtpërdrejt të zbatueshme për pushim vjetor të paguar, përfshirë të drejtën për kompensim financiar kur marrëdhënia e punës përfundon pa u përdorur pushimi. Gjykata theksoi se e drejta për pushim vjetor të paguar përmban si një komponent pushimi, ashtu edhe një komponent financiar, dhe

se mohimi i kompensimit do të cenonte efektivitetin dhe vetë thelbin e kësaj të drejte. Për rrjedhojë, dispozitat kombëtare që përjashtojnë një kompensim të tillë duhet të mos zbatohen, edhe në mosmarrëveshjet ndërmjet subjekteve private.

Arsyetimi

Gjykata vlerësoi se e drejta për pushim vjetor të paguar është mjaftueshëm e saktë dhe e pakushtëzuar. Ajo theksoi se mohimi i kompensimit financiar do të cenonte thelbin e së drejtës. Prandaj, gjykatat kombëtare duhet të garantojnë efektivitetin e plotë të kësaj të drejte, edhe në mosmarrëveshje ndërmjet individëve ose subjekteve private.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Kjo çështje konfirmon efektin horizontal të drejtpërdrejtë të të drejtave të Kartës.

13. Çështjet e Bashkuara C-609/17 dhe C-610/17 – TSN dhe AKT (2019)

Faktet

Çështjet kishin të bënin me marrëveshje kolektive pune në Finlandë, të cilat u jepnin punëmarrësve të drejtën për pushim shtesë të paguar në situata të caktuara, përtej minimumit prej katër javësh pushim vjetor të paguar të garantuar nga e drejta e Bashkimit Evropian përmes Direktivës për Kohën e Punës. Paditësit pretenduan se përjashtimi nga e drejta për të përfutur këtë pushim shtesë sipas legjislacionit kombëtar përbënte trajtim të pabarabartë dhe cenonte nenin 31(2) të Kartës së të Drejtave Themelore.

Vendimi

Gjykata vendosi se Karta nuk ishte e zbatueshme në këtë rast.

Arsyetimi

Gjykata bëri dallimin ndërmjet të drejtave të garantuara nga e drejta e Bashkimit Evropian dhe të drejtave shtesë të parashikuara nga e drejta kombëtare. Ajo pranoi se neni 31(2) i Kartës mbron të drejtën për pushim vjetor të paguar të garantuar nga e drejta e Bashkimit Evropian, konkretisht minimumin prej katër javësh të parashikuar nga Direktiva për Kohën e Punës. Megjithatë, pushimi shtesë objekt i kësaj çështjeje ishte krijuar ekskluzivisht nga e drejta kombëtare dhe shkonte përtej asaj që kërkohet nga e drejta e Bashkimit Evropian. Gjykata theksoi se e drejta e Bashkimit Evropian nuk rregullon këto të drejta shtesë. Për rrjedhojë, situata nuk binte brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian në kuptimin e nenit 51(1) të Kartës.

Gjykata sqaroi më tej se fakti që një masë kombëtare lidhet me një fushë të rregulluar nga e drejta e Bashkimit Evropian (në këtë rast, koha e punës) nuk është i mjaftueshëm për të aktivizuar Kartën. Elementi përcaktues është nëse dispozita konkrete kombëtare që po shqyrtohet rregullohet nga e drejta e Bashkimit Evropian. Meqenëse mosmarrëveshja kishte të bënte vetëm me pushimin shtesë të garantuar nga e drejta kombëtare dhe jo me minimumin e garantuar nga e drejta e Bashkimit Evropian, nuk ekzistonte një lidhje e mjaftueshme për të aktivizuar zbatimin e Kartës.

Gjetja kryesore / Rëndësia e çështjes

Karta nuk zbatohet kur një situatë ka të bëjë ekskluzivisht me të drejta të krijuara nga e drejta kombëtare që tejkalojnë standardet minimale të vendosura nga e drejta e Bashkimit Evropian. Kjo çështje ilustron se, edhe brenda një fushe të rregulluar nga e drejta e Bashkimit Evropian, Karta zbatohet vetëm për ato aspekte që bien vetë brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit.

4.3 Përmbledhje e Studimeve të Rasteve (Moduli 3)

Studimi i Rastit 1 – Fusha e Zbatimit të Kartës

Z. A është gazetar në një shtet anëtar dhe publikon raportime investigative mbi praktikën e mbikëqyrjes së kryera nga autoritetet shtetërore. Autoritetet kombëtare nisin procedime penale ndaj tij në bazë të legjislacionit kombëtar që ndalon zbulimin e informacionit të klasifikuar.

Gjatë procedurave, Z. A argumenton se të drejtat e tij sipas Kartës – veçanërisht liria e shprehjes dhe mbrojtja e të dhënave personale – janë shkelur. Ai pretendon se regjimi i mbikëqyrjes bazohet pjesërisht në legjislacion kombëtar që zbaton direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e komunikimeve elektronike dhe ruajtjes së të dhënave. Qeveria argumenton se procedimet penale lidhen me sigurinë kombëtare, një fushë që bie jashtë kompetencave të Bashkimit Evropian. Nga faktet rezulton se masat e mbikëqyrjes të përdorura nga autoritetet përfshijnë të dhëna të marra në bazë të legjislacionit kombëtar për sigurinë kombëtare dhe të dhëna të mbledhura nga ofruesit e shërbimeve të telekomunikacionit në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit Evropian..

Z. A argumenton më tej se përdorimi i këtyre të dhënave në procedimet penale krijon një lidhje të mjaftueshme me të drejtën e Bashkimit Evropian për të aktivizuar zbatimin e Kartës. Gjykata kombëtare ka dyshime nëse çështja bie brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe nëse, për pasojë, duhet të vlerësojë përputhshmërinë e masave kombëtare me Kartën.

Pyetje relevante:

- a. A bie situata brenda fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit Evropian?
- b. Cila dispozitë e Kartës është relevante në këtë rast?
- c. A ekziston një lidhje e mjaftueshme ndërmjet masave kombëtare dhe së drejtës së Bashkimit Evropian?
- d. Cilët elementë të çështjes janë thjesht kombëtarë dhe cilët lidhen me të drejtën e Bashkimit Evropian?
- e. Nëse Karta zbatohet, cilat dispozita për të drejtat e njeriut janë relevante?

Studimi i Rastit 2 – Niveli i Mbrojtjes (E drejta e BE-së kundrejt standardeve kombëtare)

Znj. Boss është shtetase rumune dhe subjekt i një Urdhri Evropian Arresti të lëshuar nga një shtet tjetër anëtar për vepra penale që lidhen me mashtrimin. Ajo është gjykuar dhe dënuar në mungesë, duke qenë e përfaqësuar nga një avokat i emëruar. Sipas legjislacionit të shtetit lëshues, vendime të tilla janë të lejueshme nëse respektohen disa garanci procedurale.

Megjithatë, legjislacioni rumun ofron një nivel më të lartë mbrojtjeje, duke kërkuar që personat e dënuar në mungesë të kenë të drejtën e një rigjykimi të plotë pas kthimit të tyre. Znj. Boss argumenton para gjykatës rumune se dorëzimi i saj do të cenonte të drejtat themelore të garantuara nga Kushtetuta rumune dhe nga Karta, pasi ajo nuk ka pasur përfaqësim juridik efektiv gjatë procesit penal.

Ndërkohë, e drejta e Bashkimit Evropian që rregullon Vendimin Kuadër për Urdhrin Evropian të Arrestimit kërkon njohjen reciproke të vendimeve gjyqësore dhe kufizon arsyet për refuzimin e dorëzimit. Shteti lëshues jep garanci se Znj. Boss do të ketë akses në mjete juridike, por nuk garanton zhvillimin e një rigjykimi të plotë. Gjykata rumune duhet të vendosë nëse mund të mbështetet në standardet më të larta kushtetuese kombëtare për të refuzuar dorëzimin, apo nëse është e detyruar të zbatojë të drejtën e Bashkimit Evropian sipas interpretimit të GJDBE-së, edhe nëse kjo rezulton në një nivel më të ulët mbrojtjeje sesa ai i garantuar nga e drejta kombëtare.

Pyetje relevante:

- A mund të zbatojnë gjykatat kombëtare një nivel mbrojtjeje më të lartë se ai i parashikuar nga e drejta e Bashkimit Evropian?
- Cili është roli i nenit 53 të Kartës?
- A ndikon zbatimi i standardeve kombëtare në efektivitetin e së drejtës së Bashkimit Evropian?
- Si duhet t'i vlerësojë gjykata garancitë e ofruara nga shteti lëshues?

Studimi i Rastit 3 – Zbatimi Horizontal i Kartës

Znj. Abott aplikon për një pozicion pune pranë një ofruesi të madh privat të shërbimeve shëndetësore që operon në disa shtete anëtare dhe përfiton pjesërisht financim nga Bashkimi Evropian për shërbimet shëndetësore ndërkufitare. Shpallja e vendit të punës kërkon që kandidatët t'i përmbahen “vlerave dhe misionit” të organizatës, të cilat përfshijnë përkushtimin ndaj një etosi të caktuar fetar. Znj. Abott, e cila nuk ndan këto bindje fetare, refuzohet pavarësisht se plotëson kriteret profesionale.

Ajo e kundërshton vendimin para gjykatës kombëtare, duke argumentuar se kërkesa përbën diskriminim për shkak të fesë dhe cenon të drejtën e saj për mbrojtje gjyqësore efektive. Punëdhënësi argumenton se është subjekt privat dhe se Karta nuk zbatohet në mosmarrëveshje thjesht private. Megjithatë, rezultoi se punëdhënësi operon brenda një kuadri të rregulluar nga e drejta e Bashkimit Evropian për kujdesin shëndetësor ndërkufitar, legjislacioni kombëtar që zbaton direktivat e BE-së për barazinë është i zbatueshëm dhe mosmarrëveshja lidhet me interpretimin dhe zbatimin e së drejtës së Bashkimit Evropian. Gjykata kombëtare duhet të përcaktojë nëse Karta mund të invokohet në këtë mosmarrëveshje dhe nëse ajo mund të mos zbatojë dispozitat kombëtare që kufizojnë kontrollin gjyqësor të kërkesave të tilla.

Pyetje relevante:

- A zbatohet Karta në mosmarrëveshjet ndërmjet palëve private?
- A ekziston një lidhje e mjaftueshme me të drejtën e Bashkimit Evropian?
- Cilat dispozita të Kartës mund të invokohen drejtpërdrejt?
- Cili është roli i gjykatave kombëtare në mosmarrëveshje të tilla?

Studimi i Rastit 4 – Njohja e Vendimeve Gjyqësore nga Shtetet e Tjera Anëtare të BE-së

Z. Donos është subjekt i një Urdhri Evropian Arresti të lëshuar nga një shtet tjetër anëtar për ekzekutimin e një dënimi penal. Autoriteti gjyqësor ekzekutues është në dijeni të disa raporteve që tregojnë mangësi sistemike në kushtet e ndalimit në shtetin lëshues, përfshirë mbipopullimin dhe kushtet e papërshtatshme higjieno-sanitare.

Z. Donos paraqet prova që tregojnë se i. institucionet e ndalimit në shtetin lëshues janë konstatuar në mënyrë të përsëritur nga GJEDNJ si shkelëse të të drejtave themelore; ii. personat në paraburgim shpesh mbahen në kushte që mund të përbëjnë trajtim çnjerëzor ose degradues; iii. ai ka gjasa të vendoset në institucione të tilla nëse dorëzohet.

Shteti lëshues pranon se kanë ekzistuar mangësi të caktuara, por jep vetëm garanci të përgjithshme se kushtet aktuale të ndalimit janë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Ai nuk jep detaje dhe garanci konkrete për situatën individuale të Z. Donos, pasi ende nuk dihet se në cilin institucion do të vendoset. Gjykata kombëtare ekzekutuese duhet të vendosë nëse mund të refuzojë dorëzimin mbi bazën e këtyre shqetësimeve, duke marrë në konsideratë parimin e besimit të ndërsjellë dhe detyrimin për njohjen e vendimeve gjyqësore të shteteve të tjera anëtare.

Pyetje relevante:

- a. A janë autoritetet gjyqësore të një shteti anëtar të detyruara të njohin vendimet gjyqësore të një shteti tjetër anëtar?
- b. Çfarë është parimi i njohjes reciproke dhe besimit të ndërsjellë në të drejtën e Bashkimit Evropian?
- c. A mund të refuzohet dorëzimi në bazë të një Urdhri Evropian Arresti për shkak të shqetësimeve lidhur me të drejtat themelore?
- d. Si duhet të vlerësohen mangësitë sistemike?
- e. A kërkohet gjithmonë një vlerësim individual?
- f. A duhet të ekzekutohet ky Urdhër Evropian Arresti?

4.4 Udhëzues i Shkurtër Hap pas Hapi për Trajnerët (për të gjitha modulet)

1. Ky udhëzues synon të mbështesë trajnerët në zhvillimin e trajnimit në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme, duke lejuar njëkohësisht përshtatje të kufizuara sipas kontekstit kombëtar. Ai ndjek strukturën e përgjithshme të kurrikulës dhe pasqyron kombinimin e komponentit doktrinar me zbatimin praktik.
2. Trajnimi duhet të fillojë me një hyrje të shkurtër mbi Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Trajnerët duhet të shpjegojnë karakteristikat kryesore të Kartës, me fokus të veçantë në fushën e saj të zbatimit sipas nenit 51 të Kartës, pasi kjo përbën pikën e nisjes për çdo analizë juridike. Në këtë fazë duhet të prezantohet gjithashtu dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve sipas nenit 52(5) të Kartës, pasi ky dallim është thelbësor për të kuptuar efektet juridike të dispozitave të Kartës. Po ashtu, duhet të trajtohet niveli i mbrojtjes së të drejtave sipas nenit 53 të Kartës (si dhe nenit 52(3) të Kartës në lidhje me KEDNJ-në), si dhe mundësia e zbatimit horizontal të Kartës, me qëllim që pjesëmarrësve t'u ofrohet një kuadër i plotë konceptual.
3. Hapi i radhës konsiston në paraqitjen e jurisprudencës kryesore të GJDBE-së. Trajnuesit duhet të përqendrohen te arsyetimi i Gjykatës dhe kriteret e zhvilluara në jurisprudencë, dhe jo te përshkrimet e hollësishme faktike. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet çështjeve që sqarojnë se kur zbatohet Karta, si dallohet ndërmjet të drejtave dhe parimeve, dhe çfarë detyrimesh sjell kjo për gjykatat kombëtare. Qëllimi është t'u ofrohen pjesëmarrësve njohuritë dhe mjetet e nevojshme për të zbatuar jurisprudencën në praktikë.
4. Pas kësaj, trajnimi duhet të kalojë te pjesa praktike, e bazuar në raste hipotetike. Pjesëmarrësit duhet të punojnë individualisht ose në grupe të vogla. Trajnuesit duhet ta udhëheqin procesin duke i nxitur pjesëmarrësit të ndjekin një qasje të strukturuar: fillimisht të përcaktojnë nëse Karta zbatohet, më pas të identifikojnë dispozitat përkatëse, të vlerësojnë natyrën e tyre juridike dhe, në fund, të zbatojnë jurisprudencën përkatëse. Roli i trajnuesit në këtë fazë është kryesisht të lehtësojë diskutimin dhe t'i orientojë pjesëmarrësit drejt një analize të strukturuar, pa dhënë përgjigje të menjëhershme.
5. Më pas, trajnimi duhet të vijojë me një diskutim plenar. Gjatë kësaj faze, pjesëmarrësit paraqesin përfundimet e tyre dhe krahasojnë qasje të ndryshme. Trajnuesit duhet të theksojnë pikat kryesore, të sqarojnë keqkuptimet dhe ta lidhin diskutimin sërish me dispozitat përkatëse të Kartës dhe jurisprudencën. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet vështirësive të përsëritura, si identifikimi i fushës së zbatimit të Kartës dhe dallimi ndërmjet të drejtave dhe parimeve.
6. Seanca duhet të përmbyllet me një fazë të shkurtër konsolidimi. Trajnuesit duhet të përmbledhin mesazhet kryesore dhe të sigurohen që pjesëmarrësit të kenë një kuptim të qartë se si zbatohet Karta në praktikë. Duhet të rezervohet kohë për pyetje dhe reflektim, duke u mundësuar pjesëmarrësve ta lidhin përmbajtjen e trajnimit me punën e tyre profesionale.
7. Gjatë gjithë trajnimit, dhe veçanërisht gjatë moduleve 3 dhe 4, trajnuesit duhet të ruajnë një qasje ndërvepruese dhe të nxisin pjesëmarrjen aktive. Theksi duhet të vendoset te zbatimi praktik dhe arsyetimi juridik i strukturuar, dhe jo te shpjegimi thjesht teorik.

4.5 Lidhje me Burimet Kryesore dhe Udhëzime Shoqëruese

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian

Teksti i plotë i Kartës është i disponueshëm online:

- Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian (teksti zyrtar):
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>

Trajnerët dhe pjesëmarrësit duhet ta përdorin këtë version si burimin autoritativ. Ai përmban të gjitha dispozitat e Kartës dhe duhet të konsultohet gjatë identifikimit të të drejtave dhe parimeve përkatëse.

Përveç kësaj, Shpjegimet Zyrtare në lidhje me Kartën ofrojnë udhëzime mbi kuptimin dhe interpretimin e dispozitave të saj:

- Shpjegimet për Kartën:
[https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32007X1214\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32007X1214(01))

Këto shpjegime janë veçanërisht të dobishme për të dalluar ndërmjet të drejtave dhe parimeve, si dhe për interpretimin e dispozitave specifike.

Informacion dhe Udhëzime Shtesë

Informacion i mëtejshëm mbi zbatimin e Kartës mund të gjendet në faqen e internetit të Komisionit Evropian:

- Karta e të Drejtave Themelore – përmbledhje dhe udhëzim:
https://commission.europa.eu/topics/human-rights/your-fundamental-rights-eu/strategy-strengthen-application-charter-fundamental-rights-eu_en

Ky burim ofron informacion praktik mbi fushën e zbatimit të Kartës, si dhe shembuj dhe materiale shpjeguese.

- Shihni gjithashtu materialet dhe burimet e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore mbi Kartën <https://fra.europa.eu/en/eu-charter/fra-charter-resources>

Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian

Jurisprudenca e GJDBE-së mund të aksesohet përmes bazës zyrtare të të dhënave:

- Baza e të dhënave e jurisprudencës së GJDBE-së (CURIA):
<https://curia.europa.eu>

Kjo bazë të dhënash u mundëson përdoruesve të kërkojnë vendime, mendime dhe urdhra të Gjykatës. Çështjet mund të kërkojnë sipas numrit të çështjes, emrit të palës ose fjalëve kyçe. Më poshtë jepet një udhëzim i shkurtër dhe më i saktë:

Në faqen e internetit zgjidhni opsionin “Case-law”. Kjo do të hapë fushën e kërkimit. Vendosni drejtpërdrejt numrin e çështjes, nëse e dini. Kjo është mënyra më e shpejtë për të gjetur një vendim specifik.

Nëse numri i çështjes nuk dihet, kërkimi mund të kryhet duke përdorur fjalë kyçe. Për shembull, mund të përdoren terma të tillë si “scope of the Charter”, “Article 51”, “fundamental rights”, ose “mutual recognition”. Shpesh është e dobishme të kombinohen fjalët kyçe për të ngushtuar rezultatet.

Lista e rezultateve do të shfaqë çështjet relevante. Duke përzgjedhur një çështje, përdoruesit mund të aksesojnë:

- tekstin e plotë të vendimit;
- përmbledhjen e çështjes;
- Mendimin e Avokatit të Përgjithshëm, kur është i disponueshëm.

Në përgjithësi rekomandohet të fillohet me përmbledhjen e vendimit, për të kuptuar çështjet dhe gjetjet kryesore, dhe më pas të konsultohet teksti i plotë për një arsyetim më të hollësishëm.

Për materialet legislative dhe jurisprudencën së bashku, mund të përdoret gjithashtu baza e të dhënave EUR-Lex:

- EUR-Lex (e drejta e BE-së dhe jurisprudenca):
<https://eur-lex.europa.eu>

Rrjeti Evropian i Trajnimit Gjyqësor (EJTN)

- Faqja zyrtare e internetit:
<https://ejtn.eu>
- Politika e BE-së për trajnimin gjyqësor (përfshirë Parimet e Trajnimit Gjyqësor të EJTN-së):
https://e-justice.europa.eu/10263/EN/eu_judicial_training
- Manuali i EJTN-së mbi Metodologjinë e Trajnimit Gjyqësor:
<https://ejtn.eu/wp-content/uploads/2023/10/Handbook-Judicial-training-methodology-in-Europe-2016.pdf>

